

37845/1

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 30.04.07 2007, Une, Marjana Shegani (Dedi)
Gjyqtare e Vetme e Gjykates se Rrethit Gjyqsor Tirane, mora ne
shqyrtim kerkesen e Kerkueses Zj. ALKETA MINEU ,me cilesine e
Administratores se shoqerise "Publicita " SH.P.K. per depozitimim e
Vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te kesaj shoqerie,
date 19.04.2007 prane Zyres se Regjistrir Tregtar. Pasi shqyrtova kerkesen
e tyre,

K O N S T A T O V A

Shoqeria "Publicita " SH.P.K. eshte person juridik shqiptar, i regjistruar ne
Regjistrin e Shoqerive Tregtare, me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane
nr. 37845, date 27.03.2007

Shoqeria ka si objekt veprimtarie:

Sherbime publicitare , shperndarje reklame ne media te shkruara dhe
elektronike , bill board , postera , fletepalosje , dekorime , organizim
evenetesh , stampime materiale promocionale ,aranzhim pavjonesh
per panaire dhe ekspozita , dhe sherbime te tjera te lidhura me to

Kapitali i shoqerise "Publicita " SH.P.K. eshte 100.000 leke dhe ortakët e
shoqerise jane si me poshte:

- Zj. Alketa Mineu ,e cila zoteron 50% te kapitalit te shoqerise ose
50 pjese kapitali me vlere prej 50.000 Leke.
- Zj. Rovena Husa ,e cila zoteron 50% te kapitalit te shoqerise ose
50% pjese kapitali me vlere prej 50.000 Leke.

Administratore e shoqerise eshte Zj. Rovena Husa

Me date 19.04.2007, Ortaket e kesaj shoqerie kane vendosur si me poshte:

1. Shitjen e plote te pjeseve te kapitalit qe zoteron ortakja
Zj. Rovena Husa perkatesisht te 50% te kapitalit,
2. Blerjen e ketyre pjeseve nga ortakja tjetere e shoqerise Zj.
Alketa Mineu

3. Largimin e Zj.Rovena Husa nga shoqeria dhe nga posti i Administratores
4. Emerimin e Zj.Alketa Mineu si administratore e shoqerise

Me realizimin e shitjes se kesaj pjese te kapitalit, Zj. ALKETA MINEU eshte ortake e veteme e shoqerise "Publicita " SH.P.K, duke zoteruar 100% te kuotave te kapitalit te saj.

Une gjyqtarja, pasi shqyrtova kerkesen e tyre dhe cmova se ajo eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj, si e tille duhet pranuar,

PER KETO ARSYE

Dhe ne baze te ligjit 7638 date 19.11. 1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe te ligjit 7667 date 28.1.1993 "Per Regjistrin Tregtar",

VENDOSA

Pranimin e kerkeses .

Depozitimim ne Regjistrin Tregtar te: Vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise "Publicita " sh.p.k date 19.04.2007 si dhe te kontrates se shitjes se kuotave nr rep 1765 dhe nr kol 404/1, date 23.04.2007 te noterise Tirane

Urdherimin e Zyres se Regjistrin Tregtar te beje depozitimim e ketyre ndryshimeve ne kolonat perkatese si dhe tu komunikoj vendimin subjekteve te interesuara .

Tirane me 30.04- 2007

GJYQTARE
Marjana Shegani (Dedi)